

VENDIM
Nr. 377, datë 8.5.2020

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, TË PASURISË NR.1/241,
ME EMËRTIMIN “TEATRI KOMBËTAR”, NË ZONËN KADASTRALE 8150,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “d”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë, me sipërfaqe totale 5 522.7 (pesë mijë e pesëqind e njëzet e dy pikë shtatë) m², me adresë: rruga “S. Toptani”, Tiranë, me qëllim ndërtimin e një godine bashkëkohore dhe me standarde të Teatrit Kombëtar, në konsultim me të gjitha grupet e interesit, sipas hartës kadastrale që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, miratuar me vendimin nr.219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të Qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Pershkrimi	Data e Lësh. Certifikates	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Pershkrimi	Data e Lësh. Certifikates	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
 Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

TIRANË, me 15 / 3 / 2018
 SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë.
 Në regjistrin Vol 30, Faqe 40, Zona Kadastrale 8150, Qyteti Tiranë



REGJISTRUESI
 VALDRIN PIETRI

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(Fragment)

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES
VALDRIN PJETRI



A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE B150 NR. PASURISË 1/241, VOL. 30, FQ. 40
INDEKSI I HARTËS TR-P-11:12, SHKALLA 1:1000

ADRESA E PASURISË: Rrethi: TIRANË, Q/P TIRANË
Rr/E "S. TOPTANI", P/G _____, Sh _____, K _____, Ap _____

B. KUFIZIMET

C. PRONARI

V. 1/63; 1/143

L. 1/66; 1/157; 1/67

J. 1/71; 1/240; 1/239; 1/62

P. 1/61

D. Data: ____ / ____ / 2018, Ora _____, Punoi _____

"SHTET"

